



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Pedagogjisë

Me datë: 13.03.2023

TEMAT MASTER për diskutimin publik					
1	Miradie Neziri- Maloku	QËNDRIMET DHE BESIMET E MËSIMDHËNËSVE NË SHËRBIM, SA I PËRKET PROCESIT TË VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË TYRE	Kryetar/e	Blerim Saqipi	Miratohet
			Mentor/e	Majlinda Gjelaj	
			Anetar/e	Naser Zabeli	
2	Tringa Reznici	Vizatimet e fëmijëve si teknikë e identifikimit të zhvillimit atipik dhe intervenimit të hershëm tek fëmijët parashkollorë	Kryetar/e	Ganimete Kulinxha	Miratohet
			Mentor/e	Blerita Perolli Shehu	
			Anetar/e	Ilir Muharremi	
3	Zyhrije Lohaj	Zbatimi i teknologjisë në mësimdhënie, në shkollat fillore të komunës së Ferizajt, gjatë pandemisë Covid-19	Kryetar/e	Hatixhe Ismajli	Miratohet
			Mentor/e	Florent Bunjaku	
			Anetar/e	Kastriot Buza	
4	Aida Halili	ROLI I SHKOLLËS NË TRAJTIMIN E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA	Kryetar/e	Januz Dervodeli	Miratohet
			Mentor/e	Majlinda Gjelaj	
			Anetar/e	Albulena Metaj	
5	Ferijan Hoxha	Qëndrimet e mësimdhënësve rreth formave të zhvillimit profesional të mësimdhënësve të arsimit fillor në funksion të mësimdhënies cilësore	Kryetar/e	Hatixhe Ismajli	Miratohet
			Mentor/e	Jehona Ferizi Miftari	
			Anetar/e	Agnesa Canta	

MIRADIE NEZIRI- MALOKU

TEMA: QËNDRIMET DHE BESIMET E MËSIMDHËNËSVE NË SHËRBIM, SA I PËRKET PROCESIT TË VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË TYRE

Prof. Majlinda Gjelaj, mentore

Prof. Blerim Saqipi- kryetar

Prof . Naser Zabeli- anëtar

Abstrakti

Në çdo institucion, qoftë publik apo privat, vlerësohet puna, arritjet, sukcesi dhe rezultatet e individit apo grupit përgjegjës, andaj edhe në sistemin arsimor vlerësohet dhe monitorohet puna e mësuesve dhe akterëve tjerë, bartës të procesit arsimor.

Mbikëqyrja, monitorimi dhe vlerësimi janë procese komplekse pa të cilat nuk ka punë efektive.

Përmes mbikëqyrjes, monitorimit dhe vlerësimit garantojmë efikasitet dhe cilësi të lartë të performancës së mësimitdhënësve, të nxënësve dhe të institucioneve arsimore. Duke pasur parasysh rolin dhe rëndësinë që ka mbikëqyrja, monitorimi dhe vlerësimi i performancës së mësimitdhënësve, e bën të domosdoshëm që ky proces të jetë i përgatitur mirë dhe me një kujdes të shtuar. Meqenëse mbikëqyrja, monitorimi dhe vlerësimi janë procese të qëllimshme, atëherë duhet përcaktuar saktë qëllimet, objektivat, fushat, mekanizmat, teknikat dhe procedurat për realizim, jo vetëm për shkak të kompleksitetit, por edhe për shkak të rëndësisë që ka, duhet të jetë i planifikuar mirë, ku do të përfshihen të gjitha detajet. Qëllimi i këtij studim është mbikëqyrja, monitorimi dhe vlerësimi i performancës së mësimitdhënësve, ndikimin e këtyre proceseve në ngritjen e nivelin të performancës në punë si dhe cilësisë në mësimitdhënie.

Kjo temë do të pasqyrojë kuadrin ligjor dhe mënyrën se si mësuesit në shërbim dhe drejtuesit e shkollave e perceptojnë politikën e vlerësimit ndaj tyre si dhe cilësinë e këtij procesi, procedurat e përdorura në arritjen e këtij vlerësimi dhe feedback-un e dhënë në këtë proces vlerësimi. Bazuar në dokumentet zyrtare të dala nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Inovacionit, procesi I vlerësimit është dizajnuar përmes formularëve të veçantë për komponentët e VPM. Komponentet e procesit të vlerësimit përfshijnë vetëvlerësimin e mësimitdhënësit, vlerësimin nga drejtori I shkollës, vëzhgimin e orës mësimore si dhe planifikimi dhe përgatitja me shkrim.

Të dhënat do të nxirren përmes zbatimit të metodës sasiore dhe cilësore, ku kriter do të jetë të shprehurit e rezultateve të kërkimit nëpërmjet anketimit vetë mësimdhënësit në shërbim dhe ndriçimin e përvojave të veçanta të mësimdhënësve, të cilat pastaj do të grumbullohen dhe përpunohen statistikisht. Qëllimi i hulumtimit është që të shqyrtojë mendimet, bindjet dhe besimet e mësuesve lidhur me vlerësimin e performancës së tyre në arsimin parauniversitar. Pyetjet të cilat do të përdoren gjatë këtij hulumtimi janë: Sa do të ndikojë vlerësimi i performancës në ngritjen e cilësisë në mësim? A janë të përgatitura institucionet arsimore për realizimin e këtij projekti?

Në këtë hulumtim, gjithsej do të përfshihen 100 respondentë, përkatësisht mësimdhënës. Grupi reprezentativ që do të jetë i përfshirë, është: dy shkolla Filllore, dy shkolla të Mesme të Ulëta dhe dy shkolla të Mesme të Larta, shkolla këto, të cilat janë ndarë sipas niveleve.

Në hulumtim, respondentët janë ndarë në meshkuj dhe femra, nga fshati dhe qyteti, me mosha të përziera, dhe me përvojë të ndryshme pune. Vlen po ashtu të theksohet se në Vushtrri disa shkolla janë të ndara, filloret nga ato të mesme të ulëta. Metodatat e hulumtimit që do të përdoren në këtë studim janë: Metoda e analizës teorike, metoda e krahasimit dhe metoda statistikore, kurse instrumentet e hulumtimit janë: Pyetëtori për mësimdhënës dhe intervista me drejtorët dhe inspektorët e arsimit.

Përmes këtij hulumtimi do të paraqes dhe adresoj nevojat për zhvillimin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve, rolin e bartësve të këtij procesi, shfrytëzimin dhe zhvillimin e proceseve të përmirësimit për vlerësimin të performancës së mësimdhënësve, ngritjen përgjegjesisë dhe llogaridhënjës si dhe në përmirësimin ngritjes së cilësisë në arsim.

Fjalët kyçe: Vlerësim, mësimdhënës, performancë, cilësi, rezultate.

TRINGA REZNIQI

Tema: Vizatimet e fëmijëve si teknikë e identifikimit të zhvillimit atipik dhe intervenimit të hershëm tek fëmijët parashkollorë

Komisioni:

Prof. Ass. Dr. Ganimete Kulinxha, kryetar

Prof. Ass. Dr. Blerta Perolli Shehu, mentor

Prof. Asoc. Dr. Ilir Muharremi, anëtar

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij studimi është të eksplorojë efektin e përdorimit të vizatimeve si teknikë e identifikimit të zhvillimit atipik dhe intervenimit të hershëm tek fëmijët parashkollorë. Fëmijët përfshihen në vizatimet e tyre të para duke zhgarravitur kudo dhe duke eksperimentuar me këtë aktivitet që është zanafilla e të gjitha proceseve të mëvonshme.

Përmes fotografive, imazheve dhe simboleve, krijuesi i artit komunikon ndjenjat dhe mendimet dhe krijon rrugë për të tjerët për të kuptuar atë që shpesh qëndron përtej fushës së vetëdijes verbale. Kur një fëmijë parashkollorë vizaton, ai po na ofron një dritare drejt kuptimit të tij në zhvillimin e botës dhe marrëdhënies së tij me njerëzit, gjërat dhe vendet përreth tij.

Duke nisur nga këto fakte qëllimi i këtij studimi bazohet mbi interpretimin e vizatimeve të fëmijëve parashkollorë duke u fokusuar në rolin identifikues të vonesave në zhvillimin motorik, mendor dhe socio-emocional të fëmijëveq dallimeve në të vizatuar në mes fëmijëve me zhvillim tipik dhe fëmijëve me zhvillim atipikç si dhe përdorimin e vizatimeve si intervenues i hershëm. Metodologjia e këtij hulumtimi është e kombinuar ku si instrumente do të përdoren pyetësorët me pyetje të hapura dhe të mbyllura dhe testi projektues House-Tree-Person. Pyetësorët do të plotësohen nga edukatorët e tri kopshteve, ndërsa testi projektues do të bëhet nga fëmijët e moshave parashkollorë të po atyre kopshteve në klasa inkluzive. Pra, meqë fëmijët me zhvillim atipik janë pjesë e institucioneve parashkollorë inkluzive atëherë përmes këtij studimi do të nxirren përfundime se sa e vlerësojnë edukatorët rëndësinë e artit rreth identifikimit të nevojave të veçanta të fëmijëve përmes tij dhe intervenimeve të hershme, dhe të nxirren rekomandime konkrete për përdorimin e artit për këto qëllime.

Fjalët kyçe: *intepretimi i vizatimeve, zhvillimi atipik, identifikimi, intervenimi i hershëm, terapia e artit.*

ZYHRIJE LOHAJ

Tema: Zbatimi i teknologjisë në mësimdhënie, në shkollat fillore të komunës së Ferizajt, gjatë pandemisë Covid-19

Komisioni:

1. Prof.Ass.Dr. Florent Bunjaku – mentor
2. Prof.Dr. Hatixhe Ismajli - kryetare
3. Prof.Asoc.Dr.Kastriot Buza – anëtar

ABSTRAKTI

Rreth 1 miliard e 600 milionë nxënës dhe studentë, në më shumë se 180 shtete të botës, përfshirë edhe Kosovën kanë kaluar në mësimin online, pas mbylljes së shkollave dhe universiteteve, për shkak të masave parandaluese të ndërmarra nga shtetet, kundër përhapjes së Covid-19.

Prandaj ky studim synon të hulumtoj zbatimin e teknologjisë në mësimdhënie, në shkollat fillore në komunën e Ferizajt gjatë pandemisë Covid-19, duke filluar nga ajo se cilat kanë qenë përvojat e mësimdhënësve për përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie, dhe sa kanë pasur nxënësit njohuri për platformat e mësimin online të cilat janë përdorur gjatë pandemisë Covid-19. Kemi përshkruar dhe analizuar procesin e mësimin online gjatë pandemisë Covid-19.

Për mbledhjen e të dhënave është përdorur pyetësori, i cili është realizuar me (N=120) nxënësë dhe (N=30) mësimdhënës të dy shkollave pjesëmarrëse në hulumtim, njëra shkollë ka qenë në qytetin e Ferizajt dhe shkolla tjetër në fshatin Komogllavë në komunën e Ferizajt.

Rezultatet e dalta nga ky hulumtim na tregojnë se zbatimi i teknologjisë në mësimdhënie, në shkollat fillore të komunës së Ferizajt, gjatë pandemisë Covid-19, nuk ishte në nivelin e duhur.

Mësimdhënësit nuk kishin përvojë të duhur, gjithashtu konfirmohet se nxënësit nuk posedojnë pajisje teknologjike të mjaftueshme. Përgjatë periudhës së pandemisë COVID-19, mësimdhënësit kanë përdorur alternativa të ndryshme për të realizuar mësimin në distancë ose online.

Rekomandohen Ministria e Arsimit (MASHTI) në bashkëpunim me Drejtorin Arsimor të Komunës (DKA) mbështetjen dhe trajnimin e mësimdhënësve, investimet në infrastrukturën e shkollave fillore, përgaditja e nxënësve për përdorimin e teknologjisë dhe mësimin në distancë etj.

Fjalët kyçe: Covid-19, mësimdhënia, mësimi në distancë, pajisje teknologjike, sfidat.

FERIJAN HOXHA

Tema: Qëndrimet e mësimdhënësve rreth formave të zhvillimit profesional të mësimdhënësve të arsimit fillor në funksion të mësimdhënies cilësore

Komisioni:

1.Prof. Dr. Hatixhe Ismajli, kryetar

2.Prof. Ass. Dr. Jehona Ferizi Miftari, mentore

3.Prof. Ass. Dr. Agnesa Çanta, anëtare

Abstrakti

Edhe pse është bërë progres në sigurimin e mbështetjes profesionale për mësimdhënësit e arsimit fillor, vazhdojnë të jenë të pranishme sfidat për zbatimin e risive në metodologji të mësimdhënies. Praktikrat e deritanishme kanë vënë në diskutim ndikimin që kishte zhvillimi profesional i mësimdhënësve, në jetësimin efektiv të risive metodologjike në klasë. Ky studim heton format e mbështetjes së zhvillimit profesional që u janë ofruar mësimdhënësve, gjatë viteve të punës së tyre në mënyrë që nëpërmjet tyre të arrijnë të përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies. Në këtë studim është përdorur qasja sasiore. Instrument për mbledhjen e të dhënave ka qenë pyetësori.

Në mostrën e përgjithshme të hulumtimit janë përfshirë gjithsej 102 mësimdhënës të arsimit fillor, që punojnë në shkollat publike dhe ato private në qytetin e Prizrenit. Rezultatet nga analiza dhe përpunimi i të dhënave kanë vërtetuar se trajnimi është forma më e shpeshtë e zhvillimit profesional por duke e theksuar nevojën që ato të jenë sa më praktike, po ashtu edhe zhvillimi profesional me bazë në shkollë është formë e zhvillimit profesional prej së cilës mësimdhënësit kanë përfituar. Ndërsa hulumtimet e përbashkëta grupore, mbështetja mentoruese, grupet hulumtuuese, videoregjistrimet e orës mësimore janë format më pak të përdorshme ose fare hiq, por për të cilat mësimdhënësit mendojnë se ndikimi i tyre në funksion të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie është i madh.

Fjalët kyçe: *format e zhvillimit profesional, mësimdhënie cilësore, arsim fillor.*

AIDA HALILI

Tema: ROLI I SHKOLLËS NË TRAJTIMIN E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Komisioni: Prof. Asoc. Majlinda Gjellaj- mentore

Prof. Dr. Januz Dervodeli- kryetar

Prof. Ass. Albulena Metaj

ABSTRAKT

Fokusi kryesor i këtij studimika për qëllim të përshkruajë dhe analizojë mënyrat e trajtimit të fëmijëve me nevoja të veçanta nga ana e akterëve kryesor në sistemin e arsimor si: drejtorët, mësimehdhënësit, bashkëmoshatarët dhe prindërit e fëmijëve. Rëndësia e trajtimit të fëmijëve me nevoja të veçanta paraqet një temë aktuale në shoqërinë tonë andaj si rrjedhojë kjo çështje mbështetet edhe në teoritë humaniste, sociale, kognitive etj. Në vendin tonë kjo temë ngërthën në vete disa probleme bazike, disa prej tyre janë se aspekti trajtues është më shumë subjektiv, nga ndjenja vetjake e mësimehdhënësve sesa e ndërtuar mbi parime dhe norma të caktuara, ndonjëherë edhe përfshirja në të nxënëështë formale, nuk respektohet diversiteti, e drejta individuale, etj. Në shoqërinë tonë ka raste të ndryshme që ballafaqohen të rinjtë mirëpo diskutimi dhe përkrahja nga të rriturit do të ndryshonte situatat në të cilën ata gjenden, prandaj shkollat duhet që të jenë simbol se si duhet të trajtojmë të tjerët, pavarësishtqdo nevoje që mund të kemi. Zbatimi dhe respektimi i të drejtave themelore duhet të kuptohet më së miri në institucione shkollore sepse aty edukohen të rinjtë tanë. Prandaj ky studim do të ketë në qendër më së shumti pikat kryesore: se si akterët shkollor janë model, në atë se si duhet të trajtohen fëmijët me nevoja të veçanta. Studimi bëhet në formë përshkruese, përdoret kjo formë sepse do të mundësojnë që studimi të paraqet për lexuesin përshkrimin e gjendjes aktuale në shkolla. Ky studim do të mbështetet në metodën cilësore dhe sasimore(mikse), sepse përdorimi i këtyre dy teknikave do të na mundësojë të kemi një përshkrim më të detajuar të gjendjes momentale dhe dhënien e arsyeve më të besueshme për ndryshimet që duhet bërë. Teknikat e përdorur në këtë studim janë pyetëtori dhe intervista e gjysmë-strukturuar. Nga rezultatet e këtij studimi, synohet që të gjenden rezultate reale të cilat do të jenë një pasqyrë e përgjithshme e gjendjes aktuale të vendit tonë në lidhje me çështjen që do të studiohet.

Fjalë kyçe:; Fëmijë me nevoja të veçanta, klasa gjithëpërfshirëse, mësimehdhënës, prindër, trajtim, shkollëetj.